

***Working to strengthen regional cooperation in the Western Balkans:  
Achievements and Prospects***

***26<sup>th</sup> and 27<sup>th</sup> of November 2015, Jahorina, Bosnia and Herzegovina***

Gjatë diskutimeve në konferencën rajonale në Jahorinë, Bosnjë dhe Hercegovinë, që u mbaj më 26 dhe 27 nëntor 2015, u përmendën disa pika kryesore, konkluzione dhe rekomandime nga parlamentarët, ekspertët dhe ministrat e Ballkanit perëndimor. Konkluzionet dhe rekomandimet nuk kanë të detyrueshme për parlamentet dhe shërbejnë si pika veprimi që mund të propozohen nga anëtarët e komisioneve të RKP për përmirësim të mëtutjeshëm të IPA 2, dhe mbikëqyrjes buxhetore dhe financiare në Ballkanin Perëndimor.

Rrjeti njih arritjet në 3 vitet e kaluara, gjithashtu të përmendura në raportin e fundit për vlerësim të iniciativave rajonale parlamentare me mandat nga Komisioni Evropian<sup>1</sup> ku kërkohet bashkëpunim rajonal më i thellë dhe më i intensifikuar mes parlamenteve të Ballkanit Perëndimor që më afër të ndjekin agjendën e Berlinit, konkluzionet e konferencës së Vjenës dhe qëllimet kryesore për integrim evropian të vendeve të Ballkanit perëndimor.

**Në fushën e integritit evropian dhe mbikëqyrjen e IPA 2 fondeve**

- Parlamentet në Ballkanin perëndimor duhet të përdorin ekspertizën dhe njohuritë nga sektori civil që të mund të përfshihen në procesin e negociatave me BE bazuar në prova;
- Parlamentet duhet të përfshihen në mbikëqyrje më intensive mbi efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimit të IPA 2 fondeve, duke përdorur praktika të mira të mbikëqyrjes nga parlamentet dhe sektori civil i Ballkanit perëndimor.
- Aty ku ka hapësirë, parlamentet duhet të risin angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e programimit dhe planifikimit të IPA 2 fondeve në nivel shtetëror;
- Parlamentet pjesëmarrëse në Rrjet duhet të bashkëpunojnë në rajon që të zbatojnë dhe qasin IPA 2 fondet, që mund të përdoren për zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të parlamenteve, në nivel shtetëror dhe rajonal dhe të bashkëpunojnë me VFD në përgatitjen e aplikacioneve për projekte të tilla rajonale për parlamente.

---

<sup>1</sup> [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/enlargement\\_process/2015-02-17-mapping\\_and\\_analysis\\_report.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/enlargement_process/2015-02-17-mapping_and_analysis_report.pdf)  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/enlargement\\_process/2015-02-17-capacity-building-report.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/enlargement_process/2015-02-17-capacity-building-report.pdf)

## **Në fushën e mbikëqyrjes buxhetore dhe financiare**

- Rrjeti i komisioneve parlamentare mirëpret themelimin e zyrës parlamentare për buxhet në Kuvendin Kombëtar të Republikës së Serbisë si ZPB e parë në rajonin e Ballkanit perëndimor.
- Pjesëmarrësit në rrjet mirëpresin shpërndarjen e praktikave të mira në mbikëqyrjen financiare dhe buxhetore në nivel rajonal dhe shpresojnë se do të ketë më shumë shqyrtime rajonale mbi mbikëqyrjen buxhetore dhe financiare në nivel bilateral dhe multilateral.
- Aty ku ka mundësi, parlamentet, në bashkëpunim me VFD dhe donator tjerë të mundshëm duhet të themelojnë zyra të tilla dhe mësojnë mbi praktikat më të mira nga bashkëpunimi i VFD parlamentin serb në rajonin e Ballkanit perëndimor.
- Rrjeti inkurajon pjesëmarrësit të ndjekin konkluzionet dhe rekomandimet nga konferenca rajonale për mbikëqyrje buxhetore dhe financiare që u mbajt në Tiranë, më 20-21 shkurt 2015.

## **Mbi zbatimin e konkluzioneve të Vjenës dhe agjendës së Berlinit**

- Ka rol për parlamentet në përmirësimin dhe zmadhimin e komunikimit në lidhje me procesin e Berlinit, duke e afruar qytetarëve dhe duke rritur debatin e brendshëm mbi të në sesionet parlamentare.
- Një prej detyrave kryesore në periudhën e ardhshme duhet të jetë Metodologjia për prioritizimin e projekteve që rrjedhin nga konferenca e Berlinit dhe Vjenës. Deputetët duhet të bashkëpunojnë me kolegët nga Ballkani perëndimor për të koordinuar platformat, dhe kështu të përkrahin procesin. "Agjenda e lidhjes" duhet të jetë një prej prioriteteve në forumet rajonale të deputetëve.
- Gjatë konferencës, ministrat e punëve të jashtme të BH, dhe të çështjeve të BE të Serbisë njohën vlerën e rrjetit të komisioneve parlamentare për ekonomi, financa dhe integrim evropian të Ballkanit perëndimor dhe kërkuan bashkëpunim më të thellë parlamentar brenda këtij rrjeti dhe dhanë përkrahje për iniciativat e tyre të ardhshme.
- Rekomandojmë që Rrjeti i komisioneve parlamentare dhe parlamentet pjesëmarrëse të përfshihen në analizën, monitorimin dhe mbikëqyrjen e dokumenteve strategjike të lidhura me procesin e Berlinit.
- Kërkojmë që ministrat për punë të jashtme, ministrat për integrim në BE dhe ministrat e financave të themelojnë praktikë për proces të rregullt 6-mujor për raportim parlamenteve në Ballkanin perëndimor mbi gjitha projektet kombëtare dhe rajonale që rrjedhin nga procesi i Berlinit.